



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 431/6 prot.

Tiranë, më 31.10.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 693, datë 10.8.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 17.10.2023, është njoftuar vendimi nr. 693, datë 10.8.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Saimir Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 18.10.2023, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një Komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 18.10.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 693, datë 10.8.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë së subjektit Saimir Hysa”², ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 *DSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa³, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir *** Hysa”.

2.3 *KLP*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Saimir Hysa.

3. Në datën 13.6.2023, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën. Subjekti i rivlerësimit, në datën 14.6.2023, u njoh e disponoi kopje të materialeve të dosjes së tij dhe në datën 23.6.2023 dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

4. **Gjetje të ONM-së.** Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se vëzhguesi ndërkombëtar i ka përcjellë

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e *ILDKPKI*-së me nr. ***/***/***/ prot., datë ***/11.2018.

³ Shkresa e *DSIK*-së nr. ***/***/***/ prot., datë ***/11.2017, deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. ***/***/***/, datë ***/10.2022.

⁴ Raport i *KLP*-së nr. ***/***/***/ prot., datë ***/4.2023.

Komisionit, 2 (dy) Gjetje të ONM-së lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterit profesional, konkretisht: *Gjetje, (i) me nr. 393 prot., datë 26.6.2023; si dhe Gjetje (ii) me nr. 402 prot., datë 27.6.2023*, me qëllim vijueshmërinë e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 29.6.2023, vendosi riçeljen e hetimit administrativ.

5. Në përfundim të hetimit administrativ shtesë, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar si vijon:

5.1 *Për vlerësimin e pasurisë.* Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas shkronjës “a” të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh se mungesa e burimeve të ligjshme, në një vlerë totale prej 706.720 lekësh, për blerjen e pasurisë *automjet*, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

5.2 *Për kontrollin e figurës.* Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

5.3 *Për vlerësimin e aftësive profesionale.* Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

6. *Vendimi i Komisionit.* Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 693, datë 10.8.2023, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe të nenit 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, ka vendosur:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

*2. Transferimin e çështjeve që i korrespondojnë kallëzimit penal nr. ***, datë ***.12.2019, dhe procedimit penal nr. ***/*** të vitit 2017, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.*

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

7. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁵ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁶ e ligjit nr. 84/2016, një Komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 18.10.2023,

⁵ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

⁶ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 693, datë 10.8.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa (bashkëlidhur këtij ankimi).

7.1 Në pikën 4, “Arsyet e ankimit të vendimit”, Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit duket se nuk ka krijuar bindjen se nëse, duke konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të duhur faktet, rrethanat dhe provat, për çështjet e trajtuara gjatë hetimit administrativ.

7.2 Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ shtesë, në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, më konkretisht për çështjet si vijon:

7.2.1 *Për kriterin e aftësive profesionale:* (1) Kallëzimin penal nr. ***/2022 ; (2) Kallëzimin penal të shtetasit ***. ***.; (3) Denoncimin e shtetasit ***. ***.; (4) Rastin e hetimit të çështjes së lidhur me shoqëritë ***-***; (5) Denoncimin e shtetasit ***. ***.; (6) Denoncimin e shtetasit ***. ***.

7.2.2 *Për kriterin e pasurisë:* (1) Të ardhurat e padokumentuara të bashkëshortes së subjektit për vitet 1999-2004; (2) Përpjekja për të paraqitur ndryshe veprimet lidhur me kontratën e shitjes së vitit 2005, për pasurinë *apartament me sip. 41 m²*, ndodhur në ***, Kavajë; (3) Mosdeklarim i burimit të krijimit për blerjen e automjetit në vitin 2015; si dhe (4) Transaksione financiare të padokumentuara me vëllanë e subjektit të rivlerësimit.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

11. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 693/2023, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, çmon se ai është i cenushtëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme

ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 693/2023, të Komisionit, në tërësinë e tij.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

13. Rezulton se hetimi i Komisionit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, është bazuar në administrimin e të gjithë burimeve të vlerësimit, ndër të tjera, verifikimin dhe analizimin e: (i) Gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncuese; si dhe (iii) raportit për analizimin e aftësive profesionale, të mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë⁷.

14. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi këto akte, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, për sa do trajtohet në vijim.

15. Komisioni, në hetimin administrativ shtesë, bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 26.6.2023, dhe datës 27.6.2023, hetoi mbi disa çështje penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, për sa do të trajtohet në vijim.

16. (1) Kallëzimi penal nr. *, me datë regjistrimi ***.6.2022**

16.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosje (*përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar, pika b.1 e Gjetjes nr. 393, datë 26.6.2023*), ka rezultuar se në Prokurorinë Tiranë është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë ***.6.2022, nga shtetasit ***. ***, dhe ***. ***, kallëzim ky i ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

16.1.1 Kallëzimi ishte ushtruar kundër: (1) SUOGJ, “Mbretëresha Geraldinë”, dhe Shërbimit të Pediatriës pranë QSUT, për neglizhencë dhe shpërdorim detyre; (2) ISHP për zvarritje të informacionit dhe moskryerje hetimi në kohë; (3) Ministrisë së Shëndetësisë, si organi më i lartë përgjegjës për shkelje të rënda dhe dëmtim pacienti nga personeli shëndetësor. Shtetasit ***. ***, dhe ***. ***, kërkonin nga Prokuroria të niste hetimet sa më shpejt për infektimin e fëmijës së tyre me HIV gjatë trajtimit në strukturat spitalore.

16.2 Subjekti i rivlerësimit, më datë ***.7.2022, ka vendosur: “*Mosfillimin e procedimit penal*”, duke arsyetuar vendimmarrjen e tij se fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale. Ky vendim është ankimuar në gjykatë nga shtetasit ***. ***, dhe ***. ***.

⁷ Nga verifikimi i Raportit për analizimin e aftësive profesionale, rezulton se në Arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ndaj prokurorit Saimir Hysa, të jenë dhënë këto masa disiplinore: (i) *Me shkresën nr. ***, datë ***.6.1994, prokurorit Saimir Hysa i jepet masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra për shkak të humbjes së materialit kallëzues nr. ***, datë ***.2.1994;* (ii) *Me Urdhër nr. ***, datë ***.11.2004 - Zbritje në detyrën e oficerit të Policisë Gjyqësore për një periudhë prej 6 muaj”.*

16.3 Gjyqtari i hetimeve paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** Regj. Them., datë ***.10.2022, ka vendosur pranimin e ankimit të shtetasve ***. ***. dhe ***. ***., si të bazuar në ligj dhe prova, duke u shprehur, ndër të tjera⁸ se: [...] *kallëzuesit kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurori, duke pretenduar hetimin e shkaqeve dhe autorëve të dëmtimit të djalit të tyre si pasojë e infektimit të tij me virusin HIV gjatë trajtimit shëndetësor në këto institucione shtetërore... Referuar materialeve gjyqësore të administruara, Gjykata konstaton se: Akuzat nuk ka shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë të plotë, të saktë dhe të gjithanshme kallëzimin penal të paraqitur nga ankuesit ***. ***. dhe ***. ***., brenda kufijve ligjorë të shqyrtimit të tij... Gjykata vlerëson se duhet të kryhen hetime në kuadër të veprës penale të parashikuar nga neni 96 i K. Penal [...].*

16.4 Kundër këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. *** datë ***.1.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.*** Regj. Them., datë ***.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

16.5 Vëzhguesi ndërkombëtar, në Gjetjen e paraqitur, lidhur me këtë rast, ka kërkuar që: [...] *të vlerësohet nga Komisioni dhe të përfshihet në rezultatet e hetimit shtesë, që subjekti i rivlerësimit të japë shpjegimet e tij lidhur me mangësitë e aftësive profesionale [...].*

16.6 Komisioni, në hetimin administrativ shtesë, ka referuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore lidhur me vërtetësinë e pretendimeve të kallëzuesve, si pasojë e të cilave Gjykata ka vendosur kthimin e çështjes dhe regjistrimin e procedimit penal dhe i kaloi subjektit barrën e provës për: (i) të shpjeguar dhe dokumentuar të kundërtën e konstatimit; si dhe (ii) të depozitohet vendimet përkatëse, të organit të akuzës dhënë nga subjekti, si dhe vendimet gjyqësore.

- Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka pretenduar se: [...] *Paraprakisht dua t'ju bëj me dije se ky procedim është ende në fazën e hetimit, regjistruar në datën **.06.2023, dhe mbështetur në kapitullin/nenin E/2 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë "Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Kallëzuesit nuk e kanë marrë mundimin të parashtronjë asnjë fjalë tjetër në kallëzim për të shpjeguar se çfarë kishte ndodhur realisht dhe për çfarë veprimesh të kundërligjshme kërkonin që organi i Prokurorisë të fillojë hetime, për më tepër që kallëzimi është bërë ndaj institucioneve dhe jo ndaj personave përgjegjës. Në rast se ju lexoni vendimin nr.*** regj. Them, datë ***.01.2022, të Gjykatës të Shkallës të Parë, Tiranë, do konstatooni se në kërkesën ankimore kallëzuesit kanë parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e faktit, gjë që nuk e kanë bërë në kallëzim. Për më tepër që ai nuk ka kallëzuar asnjë person konkret, por përmend vetëm tre organe shtetërore. Kallëzuesit në rast se nuk kishin dijeninë e dhura juridike që të formulonin një kallëzim ku në mënyrë integrale dhe të plotë të parashtronin faktin objekt kallëzimi, mund të kishin bërë këtë me ndihmën e një mbrojtësi ose duke e bërë kallëzimin, pa asnjë shpenzim, tek prokurori dhe oficeri i gatshëm i Prokurorisë të Tiranës, në një nga 8 Komisariatet e Policisë apo në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Vendimi që unë kam marrë nuk mbyllte mundësinë që fakti të hetohej, madje pasi jam njohur në fatkeqësinë e tyre, iu kam sugjeruar kallëzuesve që*

⁸ Në vendimin e saj, Gjykata ka nënvizuar mangësitë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje dhe ka urdhëruar fillimin e hetimit [...] *Nuk janë marrë deklarime të hollësishme nga ana e kallëzuesve dhe personave që kanë dijeni për rrethanat e ngjarjes... Nuk është marrë mendimi i një eksperti mjeko-ligjor në lidhje me ecurinë e gjendjes shëndetësore të fëmijës, kohën dhe vendin e mundshëm të infektimit me virus Hiv... Nuk janë marrë dhe administruar kopje të kartelave mjekësore spitalore të fëmijës[...].*

*të përpilonin një kallëzim të plotë dhe ta depozitonin, por ata kanë preferuar të ndjekin rrugën gjyqësore dhe të ankimeve ndaj meje në organet shtetërore dhe me***. Me superngarkesën që ka organi i Prokurorisë sot, është e pamundur që prokurori të marrë rol aktiv, duke marrë prova apo kryejë verifikime brenda afatit 15-ditor të përcaktuar në nenin 291/1 të K. Pr. Penale, madje na ndodh që ta kalojmë këtë afat për arsye të ngarkesës ekstreme [...].*

16.7 Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe verifikimit të dokumentacionit të administruar, ndër të tjera [...] *ka çmuar se nuk ka kompetencë në trajtimin e mëtejshëm të saj dhe as nuk mund të shprehet proporcionalisht për penalizim të subjektit në këtë vlerësim referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, referuar vendimit (JR) nr. 33, datë 3.11.2021 [...].*

16.8 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni lidhur me jurisprudencën e Kolegjit, ky i fundit ka argumentuar se: [...] *në një qëndrim të konsoliduar tashmë, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i aneksit të Kushtetutës, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit⁹[...].* Ndërkohë, referuar arsyetimit të Komisionit në rastin konkret, rezultojnë rrethanat në vendimin (JR) nr. 33/2021, të Kolegjit, paraqiten të ndryshme, pasi në atë rast kërkesa për pushimin e çështjes nga subjekti i rivlerësimit ***. ***, ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni.

16.8.1 Në rrethanat konkrete, subjekti i rivlerësimit ka mbaruar shqyrtimin e kallëzimit të analizuar, në momentin që ai, pa kryer veprime hetimore, është shprehur me vendimin për mosfillimin e procedimit, procedim i cili ndodhet në proces, vetëm për shkak se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata e Apelit kanë shfuqizuar vendimin e subjektit “Për mosfillimin e procedimit penal” dhe kanë urdhëruar regjistrimin e tij dhe kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme sipas rregullave procedurale, moskryerja e të cilave, në vetvete, materializon mangësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

16.8.2 Në vijim, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet në dosje, për sa vijon:

(i) Në kallëzimin e paraqitur, prindërit e të porsalindurit, kanë paraqitur aq informacion sa ata e kanë gjetur të mjaftueshëm, duke bashkëlidhur kallëzimit, analizat e tyre të gjakut dhe të fëmijës së infektuar. Aftësia profesionale dhe detyra e prokurorit, ndër të tjera, vlerësohet pikërisht në tregues të tillë si aftësia për të drejtuar logjikisht hetimin, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, apo aftësia për të marrë në pyetje (neni 73/2-3 i ligjit nr. 96/2016).

- Ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti, se [...] *pasi është njohur me fatkeqësinë e tyre, u ka sugjeruar që të përpilonin një kallëzim të plotë dhe ta depozitonin [...],* nga aktet në dosje rezultojnë se ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr. *** Regj. Them., datë ***.10.2022, nga subjekti i rivlerësimit është ushtruar ankim, duke passjell vonesa të mëtejshme procedurale në trajtimin e rastit, sidomos në kushtet kur kemi të bëjmë me dëmtime të pakthyeshme të shëndetit të kryer ndaj një foshnje e kur, nga ana tjetër, identifikimi i

⁹ Referohuni vendimit (JR) nr. 28/2020 të Kolegjit, prg. 14.7.

përgjegjesisë do të parandalonte ardhjen e pasojave të ngjashme në të ardhmen, gjatë trajtimit spitalor të të porsalindurve.

(ii) Pavarësisht se kallëzimi ishte bërë ndaj institucioneve dhe jo ndaj personave përgjegjës të identifikuar si të tillë, ligji nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë”, përcakton se: [...] *ndaj personit juridik që ka përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat procedurale penale për personin në hetim dhe të pandehurin*¹⁰[...]. Përgjegjësia penale e personave juridikë, po ashtu nuk përjashton përgjegjësinë penale individuale të personit, i cili, me veprimet ose mosveprimet e tij, kreu konkretisht veprën penale, përgjegjësi e cila i takon prokurorit të çështjes dhe organeve të specializuara për ta identifikuar.

(iii) Gjithashtu, edhe pretendimi i subjektit se: [...] *vendimi i mosfillimit nuk mbyllte mundësinë që fakti të hetohet* [...], tregon qasjen e tij, në drejtim të kuptuarit dhe të vlerësimit të pasojave që sjellin veprimet apo mosveprimeve e subjektit, në trajtimin e kallëzimeve penale dhe të drejtave procedurale të palëve.

16.8.3 Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vëren se në kallëzimin e analizuar, subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të aftësive për të ndërmarrë hetimin dhe mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke passjellë zvarritjen e hetimit të çështjes, pa ia nënshtruar një hetimi të gjithanshëm dhe interpretimi të drejtë të ligjit, që do të lejonte identifikimin e përgjegjesisë penale eventuale të subjekteve të përfshirë.

16.8.4 Këto rrethana, në vlerësimin e Komisionerit Publik, duhen parë edhe në drejtim të standardeve të përcaktuar nga indikatorët e nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, si një tregues domethënës i aftësisë profesionale dhe organizative, dhe mënyrës se si subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën, në referencë të rrethanave ligjore dhe faktike konkrete.

17. (2) Kallëzim penal i shtetasit *. ***.**

17.1 Nga korrespondenca e Komisionit me SPAK¹¹ ka rezultuar se ndaj shtetasit Saimir Hysa është përcjellë material kallëzues nga shtetasi ***. ***. Pas kryerjes së verifikimeve, ky material kallëzues është vendosur të dërgohet për vlerësim në Prokurorinë e Përgjithshme. Në vijim, Prokuroria e Përgjithshme¹² ka përcjellë në Komision informacion në lidhje me këtë çështje, trajtuar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës.

17.2 Prokuroria e Durrësit, me vendimin e datës ***.4.2020, “Për mosfillimin e procedimit penal”, ka dalë në përfundimin: [...] *se nuk rezulton që shtetasit e kallëzuar të kenë kryer ndonjë veprim në mospërmbyshje të rregullt të detyrës së tyre, si prokuror dhe gjyqtar* [...]. Vendimi i pushimit i referohet kryesisht argumentimit se prokurorët veprojnë në mënyrë të pavarur; se çështjet e pasurive të paluajtshme trajtohen nga Gjykata civile; dhe se pretendimet e z. ***. ***. ishin trajtuar tashmë nga subjekti i rivlerësimit, në hetimin e tij të viteve 2008-2009.

¹⁰ Neni 25, “Personi juridik në procedimin penal”.

¹¹ Referuar përgjigjes së këtij institucioni, përcjellë me shkresën nr. ***/* prot., datë ***.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹² Me shkresën nr. ***/* prot., datë ***.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

17.3 Komisioni, në rezultatet e hetimit fillestar, nuk ka gjetur problematika që mund të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

17.4 Vëzhguesi ndërkombëtar, referuar Gjetjes nr. 393, datë 26.6.2023, lidhur me këtë rast, ndër të tjera, ka kërkuar që: [...] *Komisioni duhet të hetojë nëse subjekti i rivlerësimit ka respektuar dhe ka vepruar në përputhje me dispozitat penale gjatë trajtimit/hetimit të çështjes, siç pretendon z. *** dhe të konsiderojë kryerjen e një analize të thellë të mangësive të treguara nga subjekti në kriterin e aftësive profesionale [...].*

17.5 Referuar Gjetjes dhe akteve në dosje të Komisionit, rezulton se z. ***. ***. parashtron se i ka blerë një tokë zonjës ***. ***, në vitin 1995, me sipërfaqe përafërsisht 3000 m,² në zonën e ***, Tiranë. Shtetasi ***. ***, e regjistroi këtë pasuri dhe u kthye në Francë, ku dhe jeton. Më pas ra në dijeni se pasuria që kishte blerë nga znj. ***. ***. i ishte shitur në vitin 2007 një personi tjetër.

17.5.1 Ky shtetas pretendon se shitja e dytë ka ndodhur nëpërmjet bashkëpunimit të paligjshëm dhe të qëllimshëm të zonjës ***. me zyrtarë të zyrës së Kadastrës etj. Për këto arsye, z. ***. ***. ka bërë një kallëzim penal ndaj znj. ***. dhe të tjerëve, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, regjistruar me nr. procedimi ***, datë ***.10.2008. Me vendimin e datës ***.8.2009, ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. *** të vitit 2009, i filluar gjithashtu mbi bazën e kallëzimit të mëparshëm të shtetasit ***. ***, për të njëjtat rrethana.

17.6 Subjekti i rivlerësimit, në datën **9.2009, ka vendosur “Pushimin e çështjes nr. ***/2008, duke argumentuar, ndër të tjera: [...] *se të dyja palët që kanë regjistruar këtë pronë duhet ta zgjidhin problemin duke ndjekur procedurat e fshirjes të regjistrimit që do të konsiderohet i paligjshëm, procedurë që është nisur prej tyre dhe më pas në rrugë gjyqësore [...].*

17.7 Shtetasi ***. ***. pretendon [...] *se nuk ka marrë asnjëherë informacion nga Prokuroria/subjekti i rivlerësimit për procedurat dhe ecurinë e çështjes. Pas shumë kërkesave në Prokurori, ai është njoftuar se çështja e tij është pushuar... ka kërkuar njoftimin zyrtar për pushimin e çështjes, por iu përgjigjën se dosja e tij kishte humbur dhe nuk mund të gjendej në arkivat e Prokurorisë [...]. Në vijim të sa më sipër, duket se z. *** ka depozituar në vitin 2020 një kallëzim penal, ndër të tjerë, dhe ndaj prokurorit të çështjes/subjektit të rivlerësimit, për shpërdorim detyre dhe humbje/vjedhje të dosjes hetimore.*

17.8 Komisioni, në hetimin administrativ shtesë, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime dhe të dokumentojë të kundërtën e konstatimeve paraprahe, pasi ka konstatuar se në gjendjen që ndodhen aktet e fashikullit penal, duket se [...]:

(i) *Hetimi i procedimit nr. ***/1.10.2008, është pushuar më datë **9.2009, nga subjekti i rivlerësimit, pas më shumë se 3 muaj, në tejkallim të afatit ligjor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale (neni 323/2);*

(ii) *Ka paqartësi nëse subjekti ka disponuar me urdhërime/vendime për shtyrje të afatit të hetimit të këtij procedimi, nga periudha tetor 2008-shtator 2009;*

(iii) *Ka paqartësi nëse janë kryer veprime të tjera hetimore pas datës **1.2009, në raport me kohën e gjatë deri në marrjen e vendimit të pushimit të procedimit penal, shtator 2009;*

(iv) *Duket tepër i vonuar në kohë njoftimi i vendimit të pushimit të hetimit, në mars 2010¹³, ndërsa çështja është pushuar në shtator 2009;*

(v) *Nuk ka të dhëna lidhur me statusin e vendimit të pushimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, pra nëse ai është ankimuar, dhe nëse PO, çfarë ka ndodhur me rastin [...].*

17.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera¹⁴, ka pretenduar se: [...] *në kuadër të hetimeve të këtij procedimi nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si autor të ndonjë vepre penale. ... Nisur nga ky fakt, nga ana ime nuk ka pasur asnjë arsye për të marrë vendim për të zgjatur afatin e hetimeve... Sipas dosjes hetimore, në faqen 10, ndodhet e qepur shkresa me objekt “njoftohet vendimi për pushimin e çështjes”, drejtuar shtetasit *** ***, në adresën e deklaruar prej tij, Rr. “*** **”, N.*/*, Tiranë¹⁵...detyra ime si prokuror i çështjes ka mbaruar në momentin kur kam dorëzuar dosjen e lidhur, brenda të cilës ndodhet edhe shkresa e njoftimit tek zv/drejtuuesi i Prokurorisë... Lidhur me sa kërkoni për statusin e dosjes, më rezulton se shtetasi *** *** kundër vendimit tim ka bërë ankim në Gjykatës e Rrethit Gjyqësor, Tiranë... Me vendimin nr. *** akti, datë ***.11.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, që ka shqyrtuar rastin, e ka rrëzuar kërkesën e bërë nga *** ***, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të datës ***.09.2009, për pushimin e procedimit penal nr. *** të 2008. Kundër këtij vendimi, shtetasi *** *** ka bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.04.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë ***.11.2010 [...].*

17.10 Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit, hetimit të kryer dhe dokumentacionit të administruar, ka konstatuar se subjekti ka dhënë sqarime të plota lidhur me këtë çështje. Për këtë çështje, Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë problematikë që të mund të ndikojë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

17.11 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet në dosje, për sa vijon:

(i) Referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, duket se gjejnë mbështetje pretendimet e z. ***. ***, se nuk është njoftuar për ecurinë e procedurave hetimore, që filluan në shtator 2008 dhe u përfunduan me aktin e marrjes së njoftimit, në mars të vitit 2010. Akti i vetëm me të cilin subjekti i rivlerësimit i është drejtuar z. ***. ***. gjatë hetimit, është procesverbali i datës *** shtator 2008, për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi ***. ***, si personi që ka dijeni për veprën penale. Në vijim, akti tjetër që i është drejtuar z. ***. ***, lidhur me ecurinë e procedimit penal, duket se është njoftimi për pushimin e çështjes, i datës *** mars 2010.¹⁶

¹³ Në vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Durrës, “Për mosfillimin e procedimit penal”, të kallëzuesit z. ***, për subjektin e rivlerësimit, referohet se: [...] *me shkresën nr. ***, datë ***.3.2010, vendimi i pushimit i është njoftuar kallëzuesit, duke e njohur dhe me të drejtën për ta kundërshtuar në rrugë gjyqësore apo te prokurori më i lartë [...].*

¹⁴ Referohuni më gjerësisht prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, të administruara në dosje të Komisionit dhe vendimit nr. 693/2023.

¹⁵ Subjekti ka vënë në dispozicion një fotokopje të librit të dorëzimit për vitin 2009 dhe një shkresë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, pa datë (___/09,2009), me lëndë: “Njoftohet vendimi për pushimin e çështjes, firmosur nga Drejtuesi i Prokurorisë ***. ***”.

¹⁶ Referohuni më gjerësisht akteve të referuara në rezultatet e hetimit administrativ shtesë në dosje të Komisionit, f.16, si dhe Rekomandimit të ONM-së f. 5, germa “e”.

(ii) Referuar rezultateve të hetimit, duket se subjekti i rivlerësimit, në periudhën janar-korrik 2009, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim hetimor. Nga korriku 2009 deri kur, me vendimin e datës *** shtator 2009, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes, ka përpiluar vetëm dy akte ¹⁷.

(iii) Vendimi nr. *** akti, datë ***.11.2010, i Gjykatës së rrethit Gjyqësor, Tiranë, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, referon faktin se ankimi i z. ***. ***, ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit, për pushimin e çështjes ***/2008 [...] është paraqitur jashtë afateve procedurale për paraqitjen e kërkesave në gjykatë, pasi ankuesi nuk provoi marrjen në dijeni për këtë vendim me prova shkresore [...]. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, kjo pasojë procedurale lidhet ngushtë dhe me dërgimin me vonesë të akteve të njoftimit nga organi i Prokurorisë.

(iv) Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në vendimin për pushimin e çështjes, ka referuar se pyetja e personit kryesor, shtetasit ***. ***, që ka qenë i autorizuar më anë të një prokure për kryerjen e kontratave të shitblerjes, ka qenë e pamundur, pasi personi prej shumë vitesh ndodhet jashtë, dhe pamundësia e pyetjes së tij bën të pamundur vërtetimin e faktit. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, nënvizon se qenia jashtë vendit e një subjekti me një status procedural të caktuar, nuk përbën një justifikim ligjor për moshetimin e plotë të një procedimi penal, sa kohë mjetet procedurale për marrjen e deklarimeve, edhe në këto raste gjejnë rregullim të posaçëm në ligj.

17.12 Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vëren se në kallëzimin penal të analizuar, subjekti ka treguar mungesë të aftësisë për të kryer me efekt procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të Prokurorisë, brenda afateve të përcaktuara, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 74/4 i ligjit nr. 94/2016.

18. Denoncim i shtetasit * *****

18.1 Denoncuesi, shtetasi *** ***, ka depozituar pranë Komisionit dy denoncime¹⁸, ku, ndër të tjera, ankohet se subjekti i rivlerësimit, pa bërë asnjë verifikim pranë ZVRPP, Tiranë, dhe pa kryer veprime hetimore, ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e shtetasit ***. ***, në të cilin ky i fundit ka kallëzuar për shpërdorim detyre, katër punonjës të ZVRPP-së Tiranë. Për këto pretendime, denoncuesi ka depozituar edhe vendimin e mosfillimit penal të kësaj çështjeje.

¹⁷ Referuar rezultateve të hetimit të Komisionit, vërehet se: (1) Në datën ***.9.2008, prokurori i çështjes/subjekti i rivlerësimit ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi *** ***, si personi që ka dijeni për veprën penale (në ndryshim nga pretendimi i z. *** se nuk ka marrë asnjëherë informacion nga Prokuroria/subjekti i rivlerësimit për procedurat dhe ecurinë e çështjes); (2) Në datën *** tetor 2008, subjekti i rivlerësimit ka vendosur për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve të ndodhura në ZVRPP dhe zyrën e noteres.

¹⁸ Në denoncimin e protokolluar (1) me nr. *** prot., datë ***.7.2022, i referohet çështjes penale nr.***/2019, për të cilin në Prokurorinë e Tiranës është paraqitur kallëzim penal ndaj drejtuesve të ZVRPP-Tiranë. Në denoncimin e protokolluar (2) me nr. *** prot., datë ***.12.2022, denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer zvarritje në dy procedime penale njëkohësisht, në procedimin penal me nr. ***/2020, ndaj noteres ***. ***, si dhe procedimin penal nr.***/2022, përcjellë Prokurorisë së Tiranës, për kompetencë nga SPAK, për falsifikim dokumentacioni ndaj tre shtetasve. Po ashtu, denoncuesi pretendon se materiali që i përket dosjes së kallëzimit penal nr. ***/2022, për falsifikim ndaj ekspertes ***. ***, i trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet.

18.1.1 Denoncuesi, po ashtu, ka pretenduar se çështja është zvarritur prej një viti, nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk paraqitej dhe se, në 8 seanca gjyqësore, prokurori i çështjes ka qenë i pranishëm vetëm dy herë.

18.2 Komisioni, në pyetëtorin nr. 4, të datës 5.4.2023, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime të detajuara mbi pretendimet e paraqitura nga z. ***, për secilin procedim penal të pasqyruar në denoncim.¹⁹

18.3 Referuar shpjegimeve të subjektit dhe akteve të paraqitura, rezulton se mbi bazën e kallëzimit penal të z. ***, ***, *për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh*, Prokuroria e Tiranës, më datë *** tetor 2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 6978, ndaj një notere për veprën penale “*Shpërdorim të detyrës*”. Prokurori i caktuar për trajtimin e kallëzimit, pasi ka kryer disa veprime hetimore, me datë ***.3.2021, ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes nr. ***/2020, pasi nuk ka elemente të ndonjë vepre penale.

18.4 Pas shkarkimit nga detyra të prokurorit të caktuar fillimisht, çështja i kaloi subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, para shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. ***/2020, duket se i ka drejtuar disa kërkesa Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për marrjen e masave për caktim prokurori në datat kur do të zhvillohej seanca gjyqësore.

18.5 Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***/*** Regj. Them., datë ***.7.2022 (dt. regj. ***.5.2021), ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi Gjykata e ka vlerësuar të papranueshme kërkesën e Prokurorisë për pushimin e çështjes penale, duke çmuar se hetimet janë të paplota dhe duhen vazhduar, pasi organi i Prokurorisë, ndër të tjera, nuk ka hetuar fare në lidhje me kallëzimin për dokument të falsifikuar (nga shënimet në vendimin përkatës, konstatohet të jetë pasqyruar [...] *Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori Saimir Hysa, në mungesë [...]*).

18.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetëtorit, ka referuar se hetimi është kryer nga një prokuror tjetër. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se seanca është shtyrë 8 herë për mungesën e subjektit, ky i fundit ka referuar se pretendimi [...] *është absurd, pasi sipas nenit 329/b/2, “kur palët nuk paraqiten ndonëse janë njoftuar rregullisht...pa paraqitur shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj [...]*. Subjekti, ka referuar se denoncuesi ka kërkuar edhe përjashtimin e gjyqtarit të çështjes dhe, në këtë kuptim, shtyrja e gjykimit për 8 seanca, nuk ka qenë rrjedhojë e mosparaqitjes së tij.

18.7 Komisioni duket se nuk vërejtë ndonjë fakt apo rrethanë, që mund të përbente provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, por vijoi hetimin mbi këtë denoncim, referuar *Gjetjes të vëzhguesit ndërkombëtar*²⁰, akt ky që, në zbatim të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë. Komisioni i kërkoi subjektit të sqarojë pozicionin e tij në gjykatë, nëse mungesat ishin të justifikuara, si dhe të depozitonte dokumente mbështetëse. Po ashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë në mënyrë bindëse kohën e gjatë që u nevojiti për të paraqitur kërkesën në Gjykatë (korrik 2021 - mars 2022) dhe

¹⁹ Komisioni i ka kërkuar të shpjegojë se në cilën fazë të hetimeve ndodhen procedimet. Nëse kanë përfunduar, sqaroni statusin e secilit prej tyre, sqaroni lidhur me të drejtën e ushtrimit të ankimit, sqaroni lidhur me vijueshmërinë në procese gjyqësore, kthimin ose jo për hetime të tjera, çfarë ka ndodhur me rastet e kërkimit për dorëheqjen tuaj nga hetimi i çështjeve, sqaroni lidhur me zvarritjet e pretenduara për kryerje të hetimeve, dhe për çdo pretendim tjetër.

²⁰ Gjetja e VN nr. 393 prot., datë 26.6.2023.

hapat/veprimet hetimore të ndërmarra për hetimin e kësaj çështje në përputhje me K. e Pr. Penale, të provuara me dokumentacion (*urdhura, vendime apo procesverbale*).

18.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit shtesë, ndër të tjera, ka referuar nenin E/2 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, sipas të cilit: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”, pasi procedimi penal në fjalë është ende në fazën e hetimit paraprak. Subjekti, në vijim, ka parashtruar se: [...] *kërkesat e denoncuesit për përjashtimin e gjyqtarëve apo prokurorëve janë të shumta, dhe vetë ky shtetas është pengesë kryesore për ecurinë normale të hetimit. Unë jo vetëm që nuk e kam zvarritur gjykimin, por pasi Gjykata vendosur të kthejë aktet për vazhdimin e hetimeve, dhe këtë vendim nuk e kam apeluar, duke menduar se kryerja e veprimeve të urdhëruara nga Gjykata do të ishte në dobi të të gjithëve, pasi ankimi do të shtynte çështjen për më shumë se dy vjet deri në pritje të gjyimit në Apel [...].*

18.9 Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimin e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar,²¹ arriti në përfundim se nuk vëren fakte apo rrethana që ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se çështja është nën hetim dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka kompetencë të mëtejshme trajtimi.

18.10 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse për çështjet e ngritura dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet e paraqitura nga subjekti, për sa vijon:

(i) Dokumentet e paraqitura tregojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i pranishëm në shumicën e seancave gjyqësore, gjatë periudhës ***.10.2021-***.7.2022, *pa paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm*. Kodi i Procedurës Penale, neni 329/b i tij, përcakton se shqyrtimi i kërkesës për pushimin e çështjes, shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë, *në prani të palëve*. Në vijim parashikohet se kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht²², ose refuzon të paraqitet, *pa parashtruar shkaqe të arsyeshme*, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.

18.11 *Në seancën e datës 15.4.2022*, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: [...] *se këtë çështje e ka marrë në dorëzim nga prokurori ***. ***, dhe ende nuk ka tërhequr fashikullin dhe nuk është njohur me aktet [...].* Aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, në konsideratë dhe të pretendimeve të denoncuesit, më së paku duket se tregojnë mungesën e veprimeve të efektshme nga ana e subjektit të rivlerësimit për një kohë të gjatë.

18.12 Për sa i përket qëndrimit të subjektit të rivlerësimit, se: [...] *nuk ushtroi ankim ndaj vendimit të gjykatës, duke qenë i vetëdijshëm se kjo do të vononte rastin për më shumë 2 vjet [...],* rezultatet e hetimit administrativ nuk tregojnë të njëjtën qasje të subjektit, në raste dhe më sensitive, siç ishte rasti i sipërtrajtuar në shkaqet e ankimit, lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë ***.6.2022.

18.13 Për më tepër, çështja nuk mund të konsiderohet si *rast në shqyrtim*. Gjetjet e rezultuara nga hetimi administrativ lidhen kryesisht me mosveprimet dhe mungesën e efikasitetit të

²¹ Referohuni akteve bashkëlidhur prapësimave të subjektit në funksion të rezultateve të hetimit shtesë.

²² Neni 329/b, pika 1. [...] *Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës, Gjykata njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, për datën dhe orën e gjyimit [...].*

subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës korrik 2021- korrik 2022. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.***/** Regj. Them., datë ***.7.2022 (dt. regj. ***.5.2021), ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, pasi organi i Prokurorisë nuk ka hetuar në lidhje me kallëzimin për *dokument të falsifikuar*, i vetmi moment procedural, për të cilin mund të konsiderohet se çështja është akoma në shqyrtim.

18.14 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë lidhur me këtë procedim penal duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

19. Çështja e aferës ***-***

19.1 Në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar nr. 402, datë 27.6.2023²³, akt ky që, në zbatim të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë, është referuar çështja ***-***, për të cilën vëzhguesi ndërkombëtar çmon se të dhënat e konstatuara duhet të jenë pjesë e procesit të rivlerësimit për subjektin.

19.2 Referuar akteve në dosje të Komisionit rezulton se ONM ka administruar dosjet përkatëse nga Prokuroria e Tiranës, ku konstatohet përfshirja e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. ***/***, të nisur në kuadër të procedimit kryesor nr. ***/2014.

19.3 *Rrethanat e procedimit penal nr. ***/2014 për aferën ***-****. Në vitin 2014, Prokuroria e Tiranës regjistroi procedimin penal nr. *** për veprat penale “*Mashtrim me pasoja të rënda*” dhe “*Pastrim të produkteve të veprës penale*”, fillimisht kundër shtetasve *** ** (përfaqësues dhe administrator i *** sh.p.k.), e më pas edhe kundër shtetasve të huaj, *** ** dhe *** ** (përkatësisht Drejtor i Përgjithshëm dhe Drejtor i Financës për *** Shpërndarje Shqipëri).

19.3.1 Sipas akteve të dosjes, *** sh.p.k. është kontraktuar nga *** Shpërndarje në vitet 2010-2011, për të mbledhur borxhet e akumuluar për llogari të *** Shpërndarje. Nga hetimet rezultoi se shtetasit ***, *** dhe ***, së bashku me persona të tjerë, ishin të përfshirë në një skemë të tjetërsimit të një vlerë prej rreth 650 milionë lekë nga *** Shpërndarje, të kryer nëpërmjet transaksioneve fiktive dhe dokumentacionit të falsifikuar.

19.3.2 Në vitin 2015, prokurori i çështjes, në atë kohë, ka ndarë çështjen e shtetasit *** (nr. ***) nga ajo e shtetasve *** dhe *** (***/***). Mësohet se shtetasi *** u gjykua dhe u dënua për “*Mashtrim me pasoja të rënda*” dhe “*Pastrim të produkteve të veprës penale*”, me 11 vite heqje lirie.

19.3.3 Në vitin 2017, shtetasit *** dhe ***, sipas dosjeve të administruara, u dërguan për gjykim për të njëjtat akuza. Në atë kohë, prokurori i çështjes ndau procedimin penal nr. ***/*** për kryerjen e veprës penale “*Mashtrim me pasoja të rënda*” dhe “*Pastrim të produkteve të veprës penale*” ndaj tyre, nga procedimi penal nr. ***/***, mbi përdorimin e dokumenteve të falsifikuara në këtë procedim penal, sipas nenit 186 të Kodit Penal, “Falsifikimi i dokumenteve”.

19.4 *Procedimi penal nr. ***/*** i vitit 2014* i është caktuar subjektit të rivlerësimit. Në datën ***.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Gjykatë kërkesën për pushimin e

²³ Administruar në dosjen e Komisionit, në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

hetimeve, duke iu referuar pikës 2 dhe 3, të nenit 186, i K. Penal²⁴. Në kërkesën e tij për pushimin e çështjes, subjekti i rivlerësimit i referohet disa veprimeve hetimore që përfshinin katër shoqëri, të cilat lidhën kontrata shërbimi në vitin 2010 me *** sh.p.k., për shuma të mëdha parash. Subjekti i rivlerësimit i referohet disa pyetje-përgjigjeve të përfaqësuesve të shoqërive të hetuara. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se të katër kontratat e shërbimit nuk janë zbatuar nga kontraktorët, megjithëse ata kanë marrë pagesa (ose pjesa më e madhe e tyre). Shoqëritë nuk i kanë kthyer pagesat e marra nga *** sh.p.k. dhe as shtetasi *** ***, në cilësinë e administratorit të ***-s, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për kthimin e pagesave.

19.4.1 Subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se ka dyshime të arsyeshme se dokumentacioni i përpiluar për këto veprime financiare nuk pasqyron realitetin dhe është fiktiv që konsiderohet si vepër penale, sipas nenit 186, “Falsifikimi i dokumenteve”, të Kodit Penal, dhe meqenëse është kryer në bashkëpunim, klasifikohet sipas paragrafit të dytë të kësaj dispozite. Në vijim, ka arsyetuar se: [...] *në rastin konkret rezulton se kanë kaluar edhe afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, për veprën penale për të cilën është bërë regjistrimi i procedimit penal të parashikuar nga neni 186/2 të K. Penal, nisur nga fakti se të gjitha këto veprime janë kryer në periudhën 2010-2011, dhe sipas afatit të përcaktuar nga neni 66/b i K. Penal, nuk mund të ushtrohet ndjekja penale për këtë vepër [...].*

19.4.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Regj. Them. nr. ***, të datës ***.11.2019, ka vendosur: [...] *kthimin e çështjes penale me nr. ***/*** të vitit 2014, për plotësimin e hetimeve paraprake [...], duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] gjatë hetimit paraprak edhe pse nga vetë prokurorët është urdhëruar kryerja e një sërë veprimesh hetimore, për gati 2 vjet nuk është kryer asnjë veprim hetimor, dhe është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes penale, për një vepër penale të ndryshme nga ajo për të cilën është i regjistruar procedimi penal²⁵[...].*

19.5 Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.***, datë ***.5.2020, ka vendosur prishjen e vendimit nr. *** akti, datë ***.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes penale ***/*** të vitit 2014.

19.6 Komisioni, rezulton se konstatoi si vijon: [...] (1) *Nuk është e qartë nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer ndonjë veprim hetimor përpara paraqitjes së kërkesës për pushim, siç përmendet në kërkesën e tij; (2) Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë i referohet mungesës së veprimeve hetimore për gati 2 vite (2017-2019); (3) Subjekti i rivlerësimit duket se i është referuar në mënyrë kontradiktore në kërkesën e tij për pushim, të dy neneve 186/2 dhe 186/3 të Kodit Penal, duke konkluduar më pas për pushim sipas nenit 186/2, për shkak të parashkrimit të veprës penale; (4) Subjekti i rivlerësimit është jokonsistent në identifikimin e falsifikimit të dokumenteve, përdorimit të tyre, përfituesve dhe mungesës së veprimeve, si nga*

²⁴ Neni 186, “Falsifikimi i dokumenteve” [...] Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet [...].

²⁵ Procedimi penal ishte regjistruar sipas nenit 186/3 dhe jo nenit 186/2 të Kodit Penal. Neni 186/3 parashikon falsifikimin e dokumenteve nga persona që kanë për detyrë t'i lëshojnë ato dhe dënohet deri në 7 vjet. Afati i parashkrimit për paragrafin e tretë është 10 vjet, pra duket se nuk ka përfunduar ende.

*shoqëritë e kontraktuara, ashtu edhe nga *** sh.p.k., duke mosidentifikuar apo hetuar përgjegjësinë e atyre që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentet (e falsifikuara), siç parashikohet qartë në nenin 186/3; (5) Çështja në fjalë duket më e rëndësishme në funksion të profilit të lartë publik, ku përfshihen interesa monetare përkatëse të shtetit shqiptar, të cilat janë dëmtuar nga veprimtaria e *** sh.p.k. dhe shoqërive të tjera të kontraktuara [...].*

19.7 Sa më sipër, Komisioni në rezultatet e hetimit shtesë i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime bindëse dhe dokumentacion provues, lidhur me mangësitë e sipërpërmendura në kontekstin e vlerësimit të aftësive profesionale.

19.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *pasi shqyrtova me kujdes kërkesën, konstatoj dhe pranoj se në faqen 2, paragrafi 4, ka një lapsus timin, kur shkruhet se: “Në kuadër të hetimeve paraprake të këtij procedimi është bërë dhe ndarja e çështjes penale ***/*** për veprën penale të “falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/3, të Kodit Penal”. Gjë që, gjithsesi, nuk lidhet me vlerësimin që unë i kam bërë rastit, por unë i jam referuar në mënyrë të gabuar një vendimi të marrë nga një prokuror tjetër. Cilësimi i veprës sipas paragrafit të 3, të nenit 186, të K.P., lidhet ngushtësisht me cilësitë e subjektit të veprës penale, si subjekt i posaçëm që duhet të jetë patjetër person zyrtar ose me funksion publik të njohur nga ligji, që në sajë të detyrës që kryen apo si përfaqësues i autoritetit shtetëror, ndërhyr në dokument ose e lëshon atë me të dhëna të rreme, duke keqpërdorur detyrën apo funksionin e tij [...].*

19.9 Në përfundim, Komisioni, duke konsideruar nga njëra anë këtë çështje komplekse, ka vlerësuar se parashtrimet e subjektit në kërkesën e tij për pushimin e çështjes, referuar veprës penale 186/2 të Kodit Penal, në raport me vendimet e gjykatave, t'i nënshtrohen kontrollit nga organi kompetent, me qëllim çmuarjen e provave, si dhe logjikën e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në analizën juridike mbi kualifikimin e saj.

19.10 Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë lidhur me këtë procedim penal janë të tilla, që nuk duhen transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por, së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

19.10.1 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse për çështjet e ngritura dhe pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet e paraqitura nga subjekti, për sa vijon:

(i) Subjekti i rivlerësimit nuk dokumentoi kryerjen e veprimeve hetimore nga momenti që i është caktuar çështja penale. Në vendimin për ndarjen e çështjes penale në vitin 2017, prokurorët e mëparshëm i referohen specifikisht nevojës për të kryer veprime hetimore për falsifikim dokumentesh;

(ii) Nga aktet në dosje nuk duket se subjekti i rivlerësimit të ketë lëshuar urdhra për zgjatjen e afateve të hetimit dhe nuk specifikoi sa kohë ai ka pasur nën hetim këtë çështje;

(iii) Subjekti i rivlerësimit interpreton në mënyrë të kufizuar nenin 186/3 të Kodit Penal, si të zbatueshëm vetëm për persona zyrtarë ose me funksion publik të njohur nga ligji që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentin, duke legjitimuar kështu mosushtrimin e ndjekjes penale për persona të tjerë, që ushtrojnë këtë detyrë.

20. Denoncim²⁶ i shtetasit *** *** (denoncimi i përsëritur tri herë)

20.1 Denoncuesi, shtetasi *** ***, i referohet një ngjarje të vitit 2007 (hetuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi), për të cilën është regjistruar procedimi penal nr.*** i vitit 2007, për veprën penale të parashikuar nga neni 99, të Kodit Penal, “Shkaktimi i vetëvrasjes”, e cila është pushuar po atë vit. Denoncuesi pretendon se shkak i vdekjes së nënës së tij ka qenë aksidenti nga një automjet dhe jo hemorragjia cerebrale, si shkak i rrëzimit të saj në shkallë.

20.2 Komisioni i kërkoi subjektit të japë sqarime më të plota të çështjes objekt hetimi, si dhe të dokumentojë statusin aktual të kësaj çështje. Komisioni nga aktet e administruara konstatoi se:

20.2.1 Pas ankimit të shtetasit ***, ***, me vendimin e datës ***.5.2009, të Drejtorisë së Hetimit dhe ndjekjes penale në Prokurorinë e Përgjithshme, është vendosur shfuqizimi i vendimit të pushimit të çështjes të datës ***.7.2007, për çështjen penale nr.***/2007, për të sqaruar shkakun e vdekjes së të ndjerës, nënës së denoncuesit.

20.2.2 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, pas shfuqizimit nga organi epror, si dhe kryerjes së disa veprimeve hetimore në vijim, në datën ***.10.2010, ka vendosur pushimin e procedimit penal, për mungesë provash.

20.2.3 Vendimi i subjektit të rivlerësimit është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. *** akti, datë ***.7.2011, me arsyetimin se duhen të kryhen disa veprime hetimore dhe, në varësi të rezultatit të tyre, të marrë vendim në lidhje me çështjen penale.

20.2.4 Në vijim, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës ***.1.2012, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr.***/2007, pasi në tërësinë e fakteve të mbledhura nuk ka asnjë lloj prove ligjore që të vërtetojë faktin se dëmtimet e znj. ***, ***. janë shkaktuar nga një aksident automobilistik.

20.3 Komisioni, në rezultatet e hetimit shtesë, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të dokumentojë, sa vijon [...]:

*(i) Veprimet konkrete të kryera përgjatë hetimit të çështjes (duke depozituar kopje të akteve procedurale të administruara në fashikullin penal), zgjatjen e hetimeve (mbi tre muaj) për një vit deri në vendimmarrjen e parë të vitit 2010 dhe për 4.5 muaj deri në vendimmarrjen e radhës datë ***.01.2012;*

*(ii) Arsyet e mosmarrjes në pyetje të shtetasit *** ***, pasi duket se është një nga dëshmitarët e drejtpërdrejtë në këtë çështje penale (për shkak të detyrave të lëna dhe nga gjykata);*

*(iii) Përse nuk është pyetur (nuk janë marrë deklarime) shkaktari i dyshuar i aksidentit automobilistik, *** ***, sikurse përmend denoncuesi se ka qenë ky shtetas;*

(iv) Nëse ndaj vendimit të vitit 2012 të Pushimit të procedimit penal është ushtruar ankim dhe nëse “Po”, në cilën fazë deri aktualisht është kjo çështje, pra në gjykim apo sërish në rihetim, apo gjendemi përpara një vendimmarrje të formës së prerë [...].

²⁶ Nr. *** prot., datë ***.4.2019, nr. ***, datë ***.4.2019, dhe nr. ***, datë ***.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

20.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *sqaroj paraprakisht se nga ana ime, në kuadër të hetimeve të këtij procedimi, nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si autor të ndonjë vepre penale. ...Nisur nga fakt, nga ana ime nuk ka patur asnjë arsye për të marrë vendim për të zgjatur afatin e hetimeve sipas nenit 324 të K. Pr. Penale, veprim që lidhet domosdoshmërisht me momentin e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale dhe jo me momentin e regjistrimit të procedimit penal. Lidhur me pyetjen e shtetasit *** (***) ***, pyetja e tij nuk është bërë e mundur për shkak se ky shtetas, sipas informacioneve që dispononte Policia Gjyqësore, ishte larguar jashtë shtetit [...].*

20.5 Në përfundim, Komisioni, në lidhje me hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, të cilat kanë rezultuar në vendimmarrje pushimi të saj, nuk vlerëson të penalizojë subjektin vetëm për faktin e rikthimit të çështjes për të tjera hetime, për sa kohë rrethanat konkrete të çështjes, nuk kanë prodhuar një situatë ku të detyrohej organi i akuzës të regjistronte emrin e personit dhe të ngrinte për të akuzën.

20.6 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se rrethanat e dala nga çështja konkrete, duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në kriterin e aftësive profesionale, lidhur me efikasitetin e veprimeve hetimore sipas nenit 74/4 të ligjit nr. 96/2016, për sa në vijim:

- (i) Subjektit të rivlerësimit i është caktuar kjo çështje në datën ***.6.2009 dhe ka bërë veprimin e parë hetimor vetëm pas 4 muajsh konkretisht më datë ***.10.2009;
- (ii) Nga data ***.12.2009 deri më ***.3.2010, edhe për 3 muaj të tjerë nuk ka hetuar dhe as ka nxjerrë ndonjë akt të motivuar për shtyrjen e hetimit;
- (iii) Në datën ***.3.2010, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për të kryer ekspertimin mjeko-ligjor me grup ekspertësh, për të përcaktuar shkakun e vdekjes, kërkesë kryesore kjo e Prokurorisë së Përgjithshme, veprim ky i bërë 7 muaj pasi i është caktuar hetimi i çështjes;
- (iv) Çështja është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, ku në asnjë rast nuk rezultojnë fakte apo rrethana që të lidhen me këtë vepër penale;
- (v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar të dyshuarin kryesor, me pretendimin që ai ka qenë jashtë territorit të Shqipërisë. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, nënvizon se qenia jashtë vendit e një subjekti me një status procedural të caktuar, nuk përbën një justifikim ligjor për mos hetimin e plotë të një procedimi penal, sa kohë mjetet procedurale për marrjen e deklarimeve, edhe në këto raste gjejnë rregullim të posaçëm në ligj.

21. Denoncimi²⁷ i shtetasit *** **

21.1 Denoncuesi, shtetasi *** **, pretendon për zvarritje procedurale dhe shkelje të rëndë të procedurës nga ana e subjektit të rivlerësimit, në procedimin penal nr.***, datë ***.12.2019. Komisioni, në rezultatet e hetimit fillestar, nuk ka konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

²⁷ Nr.*** prot., datë ***.2.2020, nr.*** prot., datë ***.2.2020, nr. *** prot., datë ***.7.2021 dhe nr. **, datë ***.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

21.2 Në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar nr. 393, datë 26.6.2023²⁸, është referuar se Komisioni duhet të konsiderojë kryerjen e një analize të thellë të këtij rasti dhe të mangësive të subjektit të rivlerësimit në kriterin e aftësive profesionale.

21.3 Nga aktet e administruara, Komisionit i ka rezultuar se, më datë ***.12.2019, Prokuroria e Tiranës, bazuar në kallëzimin e Seksionit Kundër Pastrimit të Parave, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.***, për “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, sipas nenit 287 të K. Penal²⁹.

21.4 Policia gjyqësore, ndër të tjera, ka referuar se disponon informacion lidhur me nënshkrimin e kontratës së dhurimit ndërmjet palëve ***. ***, ***. ***, dhe ***. ***, në cilësinë e dhuruesve dhe shtetasi ***. ***, në cilësinë e pranuesit të dhurimit. Nga të dhënat e siguruar dyshohet se bëhet fjalë për një kontratë shitje të hartuar në formën e një kontrate dhurimi, me nr.*** rep. dhe nr.***/* kol., datë **.10.2018, për arsye të panjohura, duke qenë se midis palëve nuk rezultojnë lidhje të tilla që nuk justifikojnë këtë akt dhurimi. Pas lidhjes së kontratës së dhurimit **.10.2018, vërehen disa depozitime (45.000 euro) nga shtetasi ***. ***, gjatë periudhës dhjetor 2018 - janar 2019, të cilat krijojnë dyshime mbi qëllimin e tyre dhe natyrën reale të kontratës së dhurimit.

21.5 Më datë 18.1.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur *mosfillimin e procedimit penal*, për shkak të mungesës së bazës ligjore për fillimin e procedimit penal. Sipas subjektit të rivlerësimit, policia nuk i referohej veprimtarisë kriminale apo veprës penale që gjeneronte paratë në fjalë. Referimi nga policia për “kontratën e shitjes së hartuar në formë dhurimi për arsye të panjohura”, sipas subjektit të rivlerësimit ishte krejtësisht i pamjaftueshëm për të pasur dyshimin më të vogël të mundshëm për ekzistencën e veprës penale për fillimin e procedimit penal.

21.5.1 Subjekti i rivlerësimit iu referua nenit 293, “*Referimi i veprës penale në prokurori*”, të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: [...] *Policia gjyqësore... i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra [...]*. Sipas subjektit të rivlerësimit, Policia nuk ka respektuar këtë dispozitë, nuk ka paraqitur asnjë element apo fakt apo hap hetimor për të provuar veprimtarinë kriminale që ka gjeneruar *cash-in*. Sipas subjektit të rivlerësimit, Policia Gjyqësore duhet të veprojë me iniciativë për verifikimin e fakteve dhe fillimin e procedimit penal dhe referimin e faktit në Prokurori.

21.5.2 Subjekti i rivlerësimit iu referua edhe një rrethane tjetër, që nuk lejonte fillimin e procedimit penal, konkretisht një vendimi të mëparshëm të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për mosfillimin e një kallëzimi tjetër penal të z. ***, të datës **.1.2019, kundër shtetasit ***. ***, me detyrë noter, ku ka pretenduar se ky shtetas ka *shpërdoruar detyrën funksionale*, duke përpiluar një kontratë dhurimi (nr.***rep./***/*kol., datë ***.10.2018), në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe është e *falsifikuar* dhe kundër shtetasve ***. ***, ***. ***, ***. ***, për kryerjen e *veprimit juridik fiktiv*. Prokuroria arsyetoi në atë kohë (*shkurt 2019*) se kontrata e dhurimit, në thelb duke qenë shitje, nuk

²⁸ Administruar në dosjen e Komisionit, në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

²⁹ Referuar vërtetimit, datë ***.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

përbënte veprë penale, nuk mund të cilësohej si e falsifikuar dhe mund të shfuqizohej nga një gjykatë civile.

21.6 Kundër vendimit për *mosfillimin e procedimit penal*, të subjektit të rivlerësimit, të datës 18.1.2020, ka bërë ankim shtetasi ***. ***. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** Regj. Themeltar, datë **.3.2020, ka vendosur mospranimin (pushimin) e kërkesës së paraqitur nga ankuesi ***. ***, për shkak se përfaqësuesja e ankuesit hoqi dorë nga kërkesa për gjykim.

21.7 Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ shtesë, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës, pasi ka konstatuar se [...]:

(i) *Subjekti ka rezultuar në vendimin e mosfillimit të procedimit penal në tejkalim të afatit të parashikuar në ligj (më datë 18.1.2020 /shih nenin 291 të K. Pr. Penale/15 ditë), pasi kallëzimi penal është regjistruar më datë 11.12.2019;*

(ii) *Bazuar në nenin 291 të K. Pr. Penale, vendimi i mosfillimit të procedimit penal është njoftuar në tejkalim të parashikimit ligjor (pas 10 ditëve të marrjes së vendimit), ku thuhet se prokurori/në këtë rast subjekti, duhet t'i njoftonte menjëherë vendimin e mosfillimit kallëzuesit/ve, ndërkohë që shkresa e Prokurorisë për njoftimin e z. *** mban datën 28 janar 2020;*

(iii) *Nuk përbën bazë ligjore për mosfillim e procedimit penal, fakti që Policia Gjyqësore nuk e ka dokumentuar plotësisht faktin/veprën ose e ka cilësuar gabimisht veprën penale, siç pretendon subjekti i rivlerësimit;*

(iv) *Subjekti ka neglizhuar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale, që konsiston të paktën në evazion fiskal të mundshëm nga ana e palëve, mosdeklarim të të ardhurave, duke lënë mënjanë dhe pastrimin e produkteve të veprës penale;*

(v) *Duket se kallëzimet e z. *** kanë adresuar dy vepra penale të ndryshme ku në rastin objekt hetimi, çështja është adresuar për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale sipas nenit 287 të K. Penal dhe, për pasojë, duket se ky kallëzim nuk mund të quhej i njëjtë apo i ndërvarur me kallëzimin e mëparshëm, datë **.01.2019, ku akuza e kallëzuesit referonte veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i K. Penal [...].*

21.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] shtetasi *** ***cilësohet si “kallëzues”, në një kohë që ai nuk e gëzon këtë cilësi, pasi kallëzimit nr.*** është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në DVP Tiranë dhe unë nuk kam patur në hetim asnjë kallëzim të bërë prej tij. Nisur nga ky fakt, unë nuk kam patur asnjë arsye që këtë vendim t’ia komunikoj këtij shtetasi brenda 10 ditëve, si kërkon VN në gjetje, dhe për këtë shkak nuk e kam bërë, duke mos i cenuar atij asnjë të drejtë dhe nuk e pranoj se kam shkelur këtë dispozitë. Komunikimi i vendimit që atij i është bërë nga Prokuroria në 28 janar 2020, nuk i është bërë me këtë cilësi, por me kërkesë të veçantë të bërë prej tij dhe unë ia kam pranuar këtë kërkesë duke i dhënë një kopje të vendimit të mosfillimit si “person i interesuar” dhe jo “kallëzues” me të drejtë ankimi. Lidhur me ...se “mosfillimi i mëparshëm i procedimit nga Prokuroria nuk përbën bazë ligjore, pasi pretendimet në denoncimin e mëparshëm i referoheshin pavlefshmërisë së kontratës sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa denoncimi i dytë i referohet pastrimit të mundshëm të produkteve

*të veprës penale.Pavarësisht termave të “mëdha” që përdor ankuesi ***, ***, në letrat e tij të pafundme, çështja në thelb është një konflikt familjar që lidhet me mosdakordësinë për mënyrën e administrimit të një pronë në bashkëpronësi të ndodhur në Durrës mes ***, ***, dhe motrave të tij. ***, ***, dhe ***, ***. Në gjetjen e ***, ***, citohet fakti se vendimi është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor të përcaktuar në nenin 291/1 të Kodit të Pr. Penale, konstatim që qëndron dhe ka ndodhur për shkak të ngarkesës të madhe që kemi patur këto kohë, si dhe faktit se në fund të vitit ka një rritje tej normale të ngarkesës, shkelje që mendoj se duhet vlerësuar nga Komisioni në kuadër të parimit të proporcionalitetit [...].*

21.9 Në përfundim, Komisioni, në lidhje me këtë rast, ka vlerësuar se proporcionalisht subjekti mund të kishte grumbulluar të dhëna apo marrë informacion mbi elementet thelbësore të faktit dhe mund të kishte kryer ndonjë veprim hetimor në kuadër të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pavarësisht informacionit jo të plotë të institucionit referues. Për një konkludim më të plotë të çështjes dhe në kushtet e ndalimit të Komisionit për zëvendësim logjik të subjektit në vendimmarrje, pa i hyrë themelit të çështjes në diskrecion të prokurorit, trupi gjykues vlerësoi që ky rast t'i kalojë për shqyrtim të mëtejshëm organit kompetent.

21.10 Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit shtesë lidhur me këtë procedim penal janë të tilla që nuk duhet të ishin transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

21.10.1 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, konstaton se:

(i) Lidhur me statusin e z. ***, nga aktet e administruara në dosje, rezulton e provuar se procedimi penal, pavarësisht se është referuar si informacion nga Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë, ka si bazë kallëzimin e shtetasit ***, ***, dhe kërkesat e vazhdueshme të këtij shtetasi në disa institucioneve shtetërore, fakt ky i pranuar dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në aktet në dosje të Komisionit, duket se shtetasi ***, ***, ka marrë dijëni, më datë 28.1.2020, për mosfillimin e procedimit penal nga subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së tij datë 18.1.2020, për zëvendësimin e prokurorit të çështjes (subjektit të rivlerësimit), drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

(ii) Nga aktet e administruara, nuk duket se kallëzimet penale të përsëritura të z. ***, ***, janë “gjë e gjykuar”, për sa kohë i referohen veprave të ndryshme penale.

(iii) Po ashtu dhe materiali i përcjellë nga DVP Tiranë duket se kishte informacione dhe të dhëna të mjaftueshme për transaksionin dhe natyrën e dyshimtë të burimit, të cilat duhet të shërbenin si indicie për verifikime të mëtejshme gjatë periudhës (nëntor 2009 - janar 2020), që subjekti ka shqyrtuar çështjen. Kualifikimi i saktë i veprës penale është kompetencë e prokurorit, si dhe fillimi i procedimit penal është gjithashtu kompetencë e tij, dhe jo e Policisë Gjyqësore, sikurse pretendohet nga subjekti i rivlerësimit.

(iv) Fakti që Policia Gjyqësore nuk e ka dokumentuar plotësisht faktin penal ose e ka cilësuar gabimisht veprën penale, siç pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbën shkak ligjor të arsyeshëm për mosfillim procedimi.

(v) Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, mbi mungesën e evazionit fiskal, *pasi sipas legjislacionit shqiptar dhurimi i pasurive të paluajtshme tatohet njësoj si shitja*, nuk qëndron, pasi në të dyja rastet ndryshon vlera mbi të cilën llogaritet tatimi mbi kalimin e së drejtës së pronësisë në varësi të çmimit të referencës në rastin e kontratës së dhurimit me çmimin real të shitjes.

22. Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vëren se mangësitë e konstatuara në vlerësimit e kriterit të aftësive profesionale nuk janë të vetmet, por ato konstatohet se ekzistojnë krahas gjetjeve në drejtim të burimit të ligjshëm të vlerësimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, duhen vlerësuar në tërësi në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, për sa do të trajtohet në vijim.

23. Gjatë shqyrtimit nga ana e Komisionerit Publik të vendimit të Komisionit nr. 682/2023, për subjektin e rivlerësimit, z. ***. ***, nisur nga gjetjet e administruara në raportin e AKSIK, rezultoi se Komisioni, në atë procedurë rivlerësimi, kërkoi të administronte pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë fashikullin hetimor të procedimit penal nr.***, *viti 2005*.

24. Nga korrespondenca mes Komisionit dhe Prokurorisë, në atë proces rivlerësimi, vendimi përfundimtar i të cilit është ankimuar nga ana e Komisionerit Publik, u konstatua se janë administruar shkresa sipas të cilave rezulton se procedimi penal ka qenë në ngarkim të shtetasit ***. ***, dhe se është regjistruar dhe hetuar nga subjekti konkret i rivlerësimit, Saimir Hysa. Nga aktet e Prokurorisë ka rezultuar se: (i) ka një vendim pushimi të çështjes penale, marrë në datën *.11.2005; (ii) nuk rezulton të jetë i pasqyruar në inventarin e procedimeve penale të pushuara për vitin 2005, (iii) nuk disponohen të dhëna nëse kundër vendimit të pushimit është paraqitur ankim apo jo, dhe se (iv) dosja e këtij procedimi penal nuk rezulton të jetë dorëzuar pranë zyrës së arkivit.

25. Komisioneri Publik vlerëson se, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të parashtrijë qëndrimin e tij, lidhur me këtë rrethanë konkrete, ku rezulton se një fashikull i procedimit penal nr. ***, i vitit 2005, që është hetuar dhe pushuar eventualisht prej tij, nuk rezulton të jetë dorëzuar pranë zyrës së arkivit së institucionit.

IV.B. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

26. Apartament banimi me sipërfaqe 41 m², i ndodhur në *, Kavajë**

26.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sipërfaqe 41 m², i ndodhur në ***, Kavajë. Blerë me kontratën nr. *** rep. dhe nr. ***/* kol., datë **.9.2005, para noteres ***. ***, në bashkëpronësi me vëllain tim, *** ***. Regjistruar pranë ZRPP Kavajë me nr. ***/***+*.-*, vol. **, fq. ***, zk ***, Kavajë. Kontributi im ka qenë në shumën 200.000 lekë, të ardhura që burojnë nga paga ime si prokuror në Prokurorinë e Tiranës. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 33,3%.*

26.2 Në DV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament 41 m², i ndodhur në Golem, blerë në muajin gusht të vitit 2005. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 1/3, 33 %.*

26.3 ASHK³⁰-ja ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij ***,**H. Nga aktet bashkëlidhur rezulton se me kontratë shitblerje me nr. *** rep. dhe nr.***/* kol., datë *.9.2005, subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij kanë blerë nga bashkëpronarët ***, *** dhe *** ***, apartamentin me sip. 41,6 m², me numër pasurie ***/***+*-. Çmimi i shitjes së apartamentit është 1.400.000 lekë, shumë e cila është likuiduar tërësisht. Kontrata ka përcaktuar gjithashtu edhe pjesët takuese të secilit bashkëpronar, ku subjekti i rivlerësimit përcaktohet zotërues me 1/3 e pasurisë, ndërsa vëllai i tij në 2/3 e saj.

26.4 Në procesverbalin e ILDKPKI-së³¹ të datës ** mars 2016, subjekti rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Fillimisht dua të sqaroj se shtysë për blerjen e kësaj banese është bërë një marrëveshje midis vëllait tim *** ***, rezident në Austri, i cili drejton një studio arkitekture *-***. Ai kishte rënë në marrëveshje me shtetasin *** ***, bashkëshorti i *** *** dhe *** ***, për projektin e një hoteli në *** Vlorë, ku shpërblimi do të ishte 1.200.000 lekë. Nga im vëlla, projekti është bërë në kohë dhe i është dorëzuar atij, por nuk i është likuiduar pagesa. Në vitin 2005, ata i kanë ofruar në këmbim të shumës një apartament garsoniere në ***, në kompleksin e ndërtuar nga *** sh.p.k. Nisur nga ky fakt, im vëlla më ofroi që unë të paguaja diferencën prej 200.000 lekë dhe unë të isha b/pronar në këtë apartament me 1/3 [...].*

26.5 Komisioni, në rezultatet fillestare të hetimit administrativ, datë 13.6.2023, nga analiza financiare e kryer lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie, duke konsideruar si pagesë të kryer nga subjekti shumën 200.000 lekë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në pjesën e tij takuese për këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare. Ndërsa i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me pagesën në shumën 200.000 lekë për këtë pasuri në raport me pjesën takuese 1/3, e cila i përket vlerës 466.667 lekë. Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet e tij në rapësimet e datës 23.6.2023.

26.6 Në vijim, Komisioni ka administruar Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar nr.393 prot., datë 26.6.2023, ku lidhur me pasurinë apartament me sip. 41 m,² ndodhur në ***, Kavajë, ndër të tjera është konstatuar:

(i) Nga raporti duket se është marrë parasysh vetëm mundësia financiare prej 200.000 lekë e subjektit të rivlerësimit dhe nuk është hetuar për mundësinë financiare të vëllait të subjektit, i cili ka investuar 1.200.000 lekë.

(ii) Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kontribuar 200.000 lekë (1/7 e çmimit të shitjes) që është shumë i ulët krahasuar me 1/3 e pjesës takuese, të njohur në kontratën e shitjes. Kjo ndarje nuk është pasqyruar në vërtetimin e pronësisë mbi këtë pasuri, ku si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe vëllai i tij, janë të regjistruar si bashkëpronarë, pra secili nga 50%. Kjo i bën shpjegimet e subjektit të rivlerësimit më pak të besueshme.

(iii) Duket se çmimi 1.400.000 lekë për 41 m,² në ***, në vitin 2004, është shumë i ulët në krahasim me të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave.

³⁰ Shkresa me nr. ***/* prot., datë **.11.2020, e Drejtorisë Vendore Kavajë dhe praktikë shoqëruese.

³¹ Administruar me shkresën nr. ***/* prot., datë **.10.2020, kthim përgjigje nga ILDKPKI.

(iv) Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vëllai ofronte shërbime, të cilat ende nuk ishin paguar nga persona të tretë dhe që shlyheshin me blerjen e këtij apartamenti. Duket se ky shpjegim i subjektit të rivlerësimit nuk është përmendur në kontratën e shitjes dhe nuk mbështetet nga ndonjë provë tjetër.

(v) Në vitin 2018, pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit i transferohet vëllait në mënyrë deklarative për të shlyer huan prej 15.000 euro, duke deklaruar se do të hiqte dorë nga një pasuri me vlerë 200.000 lekë ose 466.666 lekë (1/3 e investimit fillestar) ose 700.000 lekë (50% e investimit fillestar).

26.7 Në vijim, Komisioni ka vendosur të riçelë hetimin administrativ dhe të hetojë lidhur me gjetjen e ONM-së, duke i kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 10.

26.7.1 Lidhur me sa më sipër, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e mësipërme dhe, ndër të tjera, ka deklaruar se nga vëllai i tij nuk është paguar kjo shumë për blerjen e kësaj pasurie, pasi kjo vlerë ka qenë vlere e projektit të porositur. Çdo bisedë është bërë në kuadër të një njohje dhe miqësie të konsoliduar mes vëllait të tij me shtetasit ***.***. dhe ***.***, dhe mes tyre nuk është lidhur ndonjë kontratë porosie apo akt tjetër i shkruar, që subjekti mund të vërë në dispozicion të hetimit³².

26.8 Në përfundim, për këtë pasuri, Komisioni nuk evidentoi ndonjë fakt apo rrethanë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga subjekti apo dokumentacioni i administruar në dosje, pa pasur gjithashtu kurrfarë *indicie* apo dyshim lidhur me raportin e subjektit në tërësi me këtë pasuri, si dhe në mungesë të çdo informacioni negativ nga organet ligjzbatuese për figurën e tij në çështjen objekt vlerësimi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi e vërtetësi pjesën e tij takuese, përdorimin e kësaj pasurie, ka pasur mundësi financiare për të kontribuar në shumën 200.000 lekë për blerjen e saj, si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit për shkak të detyrës dhe, për pasojë, nuk ka asnjë rrethanë që afekton procesin e tij të rivlerësimit.

26.9 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse, për sa vijon:

(i) Mbetet e provuar se vlere e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si kontribut në blerjen e kësaj pasurie, referuar çmimit të kontratës, korrespondon me 1/7 e pjesës takuese. Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. ***/* kol., datë **.9.2005, duhej të bëhej regjistrimi i këtij apartamenti në emër të subjektit me 1/3 pjesë takuese, ndërkohë në ASHK³³ rezultoi se kjo pasuri është regjistruar në bashkëpronësi në pjesë të barabarta me vëllain e tij. Referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit³⁴ vërejmë se, nëse pagesa e kryer nga subjekti për këtë pasuri do të llogaritej në vlerën 466.667 lekë (korrespondon me 1/3 e vlerës së kontratës) ose në vlerën 700.000 lekë (korrespondon me 50% të vlerës së kontratës), atëherë subjekti do të rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme.

³² Referohuni përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr.10 dhe shpjegimeve të subjektit në prapësimet e datës 2.8.2023.

³³ Referohuni shkresës së ASHK nr.***/*, datë **.11.2020.

³⁴ Referohuni analizës financiare në rezultatet e hetimit datë 13.6.2023.

(ii) Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti nuk ka dokumentuar (1) marrëdhënien e shërbimit (*projektin e një hoteli në ***, Vlorë*), si dhe (2) shumën që do përfitonte nga ofrimi i këtij shërbimi, vëllai i subjektit të rivlerësimit nga shitësit e apartamentit në ***, Kavajë.

- Sa më sipër vlerësojmë se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ mbeten në nivel deklarativ dhe bien ndesh me parashikimet në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të datës **.9.2005, ku parashikohet *se çmimi i shitjes së apartamentit prej 1.400.000 lekë është likuiduar tërësisht*.

26.10 Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se në gjendjen që janë aktet, veprimet e vëllait të subjektit të rivlerësimit të mbështetura dhe nga subjekti i rivlerësimit, paraqesin në mënyrë të pasaktë rrethanat lidhur me pasurinë apartament me sip. 41 m,² të ndodhur në Kavajë.

27. Apartament me sip. 71,2 m², i ndodhur në rrugën “* **”, Tiranë**

27.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 71,2 m², i ndodhur në rrugën “*** **”, Tiranë. Blerë me kontratën nr. *** rep., dhe nr. ***/* kol., datë **.10.2011, para noteres ***,***. Tiranë. *Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese: 50%*.

27.1.1 Lidhur me burimet e krijimit, subjekti ka deklaruar: (i) Shumën 400.000 lekë, depozitë e përbashkët me *** ***, në *** ** Bank; (ii) shumën 17.000 euro, kursime të *** **, në *** ** Bank; (iii) Kredi bankare, në shumën 25.000 euro, marrë në *** Bank³⁵ dhe (iv) hua në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi *** ** (vëllai).

27.2 Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie rezulton se Komisioni ka analizuar secilin prej burimeve të deklaruar prej subjektit dhe, ndër të tjera, ka konstatuar:

27.3 Lidhur me burimin e deklaruar 17.000 euro, kursime të *** **, nga korrespondenca e Komisionit me *** ** Bank³⁶ ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit, shtetasja *** ** ka hapur një llogari në monedhën euro, duke depozituar fillimisht në datën **.07.2006, shumën 4.000 euro. Në këtë llogari, që prej çeljes së saj në vitin 2006 e në vazhdim janë kryer depozitime dhe tërheqje nga znj. ***, dhe gjendja e kësaj llogarie në datën **.8.2011, kur është është kryer tërheqja, ka qenë në vlerën 17.000 euro.

27.4 Komisioni ka analizuar fillimisht depozitim të shumës 4.000 euro, në datën **.07.2006, dhe nga analiza financiare i ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur mundësi në shumën - 109.495 lekë të depozitojë 4.000 euro në vitin 2006, dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, si dhe për të depozituar dokumentacion justifikues në mbështetje të shpjegimeve.

27.5 Lidhur me burimin e deklaruar hua në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi *** ** (vëllai), Komisioni ka analizuar dokumentacionin e depozituar nga subjekti për të provuar të

³⁵ Subjekti ka deklaruar gjithashtu se kjo kredi është shlyer me një hua të marrë nga shtetasi *** ** në shumën 25.000 euro, kryer me transfertë bankare nga llogaria nr. ***** e *** ** drejt *** Bank në datën **.12.2011. Huaja ndaj këtij shtetasi është shlyer totalisht në vitin 2016 sipas deklaratës noteriale të datës **.1.2017, lëshuar nga *** ** para noteres ***,***.;

³⁶ Shkresë nr. ***/* prot., datë **.10.2020.

ardhurat e huadhënësit, nga ku nuk ka konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të kësaj huaje.

27.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 23.6.2023, lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për mbulimin me burime të ligjshme të shumës 4.000 euro, nga personi i lidhur ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Sipas raportit, në analizën financiare nuk janë marrë fare në konsideratë të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortes pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën *.03.1999-*.01.2001, ku ajo ka përfituruar pagë në total shumën 550.000 lekë dhe në Institutin e Politikave Efektive Publike, ku në total ka përfituruar pagë në total shumën 700.000 lekë ... pavarësisht se nga hetimi ka rezultuar se për këto të ardhura të krijuara nga bashkëshortja (përpara se të njihej me mua) nuk janë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ... unë si subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mund të penalizohen në kuadër të procesit të rivlerësimit [...].*

27.7 Në vijim, Komisioni ka administruar Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar nr. 393 prot., datë 26.6.2023, ku ndër të tjera lidhur me pasurinë apartament me sip. 71.2 m² është konstatuar: (i) Mundësia financiare e vëllait për të dhënë huan, sipas rezultateve të hetimit, nuk është e qartë. (ii) Transferimi i shumës 15.000 nuk është sqaruar dhe dokumentuar. Subjekti i rivlerësimit deklaron në pyetësorin e 2-të se i janë dhënë 15.000 euro, në gusht 2011. Nuk ka asnjë deklaratë të gjendjes *cash* të vëllait që ka hyrë në Shqipëri me më shumë se 10.000 euro.

27.8 Lidhur me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova në përgjigjet e pyetësorit nr.10, ku ndër të tjera ka deklaruar: [...] *Shuma prej 15.000 euro më është dhënë nga vëllai im “cash” në banesën time, datën nuk e kujtoj por ka qenë muaji gusht 2011. Lidhur me mënyrën e sjelljes të kësaj shumë pyeta vëllain tim, i cili më referoi t’ju deklaroj se nuk ka patur arsye ta deklarojë atë në doganë, pasi një pjesë të saj e ka patur gjendje në Shqipëri, kurse një pjesë e ka sjellë nga Austria, në gusht 2011, por ka qenë nën shumën për të cilën ka detyrimin ta deklarojë [...].*

27.9 Në përfundim, Komisioni, pasi ka administruar shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të shumës 4.000 euro, ka arsyetuar se: [...] *pagimi i kontributeve ka qenë detyrim i punëdhënësit, si dhe faktit se këto të ardhura datojnë përpara njohjes së subjektit me bashkëshorten e tij dhe se balanca negative e rezultuar është në një masë të papërfillshme, trupi gjykues i çmon këto fakte e rrethana në harmoni me njëra-tjetrën dhe në përfundim konkludon se nuk përbëjnë shkak për të penalizuar subjektin e rivlerësimit [...].*

27.10 Ndërsa lidhur me huan në shumën 15.000 euro, dhënë nga vëllai ***.***, ndër të tjera, ka arsyetuar: [...] *Në përfundim, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit dhe analiza financiare duket se nuk identifikojnë problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj huaje, sipas kërkesave të nenit D të aneksit të Kushtetutës [...].*

27.11 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vëren se:

(i) Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të shumës 4.000 euro, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte për të provuar përfitimin faktik të këtyre të ardhurave dhe as ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga personi i lidhur nga punësimi pranë “****” sh.p.k., dhe Institutit të Politikave Efektive Publike, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

Konstatohet po ashtu se, në vërtetimin e punësimit lëshuar nga *** sh.p.k., referohet se personi i lidhur ka punuar pranë kësaj shoqërie gjatë periudhës *.3.1999 - *.1.2001, ndërsa nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie konstatohet se kjo shoqëri është regjistruar në datën **.10.1999.

(ii) Lidhur me huan në shumën 15.000 euro nga vëllai, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë akt që të verifikojë transaksionin e dhënies së kësaj huaje nga vëllai i tij, duke deklaruar se huaja është dhënë *cash*. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka depozituar kontratë huaje të datës **.11.2011, që daton disa muaj pas kohës kur pretendohet se është dhënë kjo hua, duke ngritur kështu dyshime lidhur me vërtetësinë e këtij transaksioni.

28. Automjet tip “Renault Megane”, me targë ** ***

28.1 Në *D-Vetting*, subjekti ka deklaruar: Një automjet i markës “Renault Megane”, me nr. shasie ***** dhe me targë ** ***. *Vlera: 5.700 euro+170.400 lekë detyrimi doganor. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Shitja e mjetit “Renault Megane”, me targë ** ***, sipas kontratës nr. *** rep. dhe *** kol., datë *.7.2016, lidhur para noterës ***,***.*

28.2 Në *DV-2015*, subjekti ka deklaruar: (i) Blerë automjeti “Renault Megane Scenic”, me targë ** ***. Blerë me të ardhurat nga shitja e makinës të vjetër, si dhe të ardhurat nga paga. *Vlera: 5.750 euro +1.200 euro detyrimi doganor. Pjesa takuese: 100%; (ii) Shitur automjeti “Renault Megane”, me targë ** ***. Vlera: 4000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

28.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi: [...] (1) *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën -706.720 lekë për të investuar në pasurinë e luajtshme automjet, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; si dhe (2) Duket se të ardhurat nga shitja e mjetit me targë ** *** nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri pasi mjeti është shitur 3 muaj pasi është blerë mjeti me targë ** *** [...].*

28.4 Në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, subjekti ka prapësuar se: [...] *Gjatë qëndrimit në ***-Austri, në mënyrë rastësore kam parë një mjet të markës “Renault-Megane” ...Në atë moment, natyrisht, që unë nuk e kisha me vete shumën prej 5.750 euro, me të cilën u ble mjeti, pasi udhëtimi im kishte qëllim tjetër dhe ramë dakord me vëllain tim që mjetin ta paguante ai dhe unë t’ia jepja paratë më pas, pasi të shisja dhe automjetin që kisha në atë kohë në pronësi, me targë TR ** *** [...].*

